



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-6825

Dt. 24.03.2025

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe Hartës Zonale Komunale me Nr.011/01-1392 e datës 31.01.2024, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Gabriell (Pren) Frrokaj nga Gjakova		
Adresa:	Rruga " Ganimete Terbeshi " pn.		
Telefoni:	044 247 170	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i objektit të kategorisë së parë me destinim, Objekt i banimit individual – , me etazhitet të planifikuar P+0 sipas projektit të prezantuar.		
Emri i Projektuesit:	SH.P.K. "INEX-PROJEKT", Gjakovë		
Adresa:	Rruga " Nëna Terezë" pn. - Gjakovë		
Telefoni:	044 505 576	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga " Shaban Polluzha " pn..		
Zona(t) Kadastrale: Jahoc	Nr. i parcelave kadastrale: P-70705037-01628-0	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: Lejohet Ndërtimi i objektit të kategorisë së parë me destinim, Objekt i banimit individual – , me etazhitet të planifikuar P+0, sipas projektit të prezantuar.	

Me këtë vendim, poseduesi i lejes ndërtimore **Gabriell (Pren) Frrokaj** nga Gjakova, i lejohet ndërtimi i objektit të kategorisë së parë me destinim, Objekte i banimit individual me etazhitet të planifikuara P+0 me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) për ndërtim $S= 155.64 \text{ m}^2$.

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S= 155.64 \text{ m}^2$

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistrin e hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesit: **Gabriell (Pren) Frrokaj** me banim në rr. “Ganimete Terbeshi” pn përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-6825 të datës dt. 03.02.2025, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me etazhitet të planifikuara P+0, në parcelën kadastrale me numër: 1628-0 ZK. Jahoc, në rrugën “Shaban Polluzha” pn., në pronësi të lartë përmendurit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se

janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt. 12.12.2024;
- Kopjen e planit (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 15263/2024 të datës 11.11.2024, në pronësi të **Gabriel (Pren) Frrokaj** nga Gjakova, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë;
- Aktvendimin e kushteve ndërtimore me nr.07/351/02-17335 dt. 12.12.2024, të lëshuar nga DUMM;
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë;
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 20 të datës 13.01.2025;
- Pëlqimin nga Telekom i Kosovës SH.A. nr. 229 të datës 18.12.2024;
- Pëlqimin nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, nr. 37 të datës 13.01.2025;
- Pëlqimin nga K.R.M. "Çabrati" Sh.A. Gjakovë, nr. 3061 të datës 20.12.2024;
- Përgjigjen e dt.05.03.2025 nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbi kompenzimin e tokës bujqësore në tokë jobujqësore;
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në IFJB VLLESA - CO në Gjakovë, me datë 21.03.2025;
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga SH.P.K. "INEX-PROJEKT", Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 653.42 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim.

Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për Punë Inspektuese,**
- **Arkivit.**

Zyrtari përgjegjës për lëndë:



Udhëheq. Sekt. urbanistik, Mirlinda Mullahasani, I.D.A.

